

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“JAGUARSOFT”

Date 02 Korrik 2018

Themeluesi me poshte;

Huseyin Selcuk OCMEN, shtetas turk i datelindjes **04.05.1960**, i biri i Yildirim, i identifikuar nga pashaporta me nr.U08131439, qe ne vijim do te quhet “**Ortak**”, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, vendosi te hartoje kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i shoqerise

1.1. Shoqeria ka kete objekt veprimtarie; Zhvillimin e Programeve Kompjuterike, Reklamave online, Krijimin e Faqeve WEB, Konsulence mbi programe kompjuterike dhe zhvillimeve online. Tregtim, Import – Eksport.


1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 2. Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine ta emertoje “**JAGUARSOFT**”.

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne **Tirane, Rruga “Andon Zako Cajupi” Pallati Conad, Kati II. Njesia Bashkiake nr.5**

2.3. Shoqeria mund te krijojte qendra dytesore, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.



Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2. Me vendim te tij Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin.

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.

4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.

4.6. Ortaku perballon humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 5. Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar.



Kreu III
KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte 100 000,00 (njqind mije) leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 000, 00 leke.

6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte : **Huseyin Selcuk Ocmen, 1 kuote, perkatesisht 100% te kuotes .**

6.3. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem.

6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

Neni 7. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakëve te shoqerise.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen nga ortakët, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakut te vetem.

Kreu IV
DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

8.2. Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

8.3. Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortakut i vetem, administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 9. Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise

Asambleja e pergjithshem perbehet nga ortakut i vetem i shoqerise qe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortakut i vetem.

Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti kontabel i



autorizuar ose ortaku i vetem i shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene i autorizuar me prokure te posacme dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Ortaku mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar. Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast, ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaku i vetem.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaku i vetem i shoqerise ka te drejte te marre vendime per ceshtjet e meposhtme:


- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- i) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.



Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 10

- 10.1.** Shoqeria do te administrohet nga 1 (nje) administrator i vetem, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise.
- 10.2.** Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetem.
- 10.3.** Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori, Z. Gentjan Haxhiaj** shtetas shqiptar i datelindjes **03.06.1979**, i identifikuar nga pashaporta me nr. Personal H90603145I.
- 10.4.** Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit.
- 10.5.** Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.
- 10.6.** Administratorit i takon firma e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.
- 10.7.** Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.
- 10.8.** Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane:
- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku i vetem.
 - Perfaqeson shoqerine tregtare.
 - Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
 - Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim.
 - Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
 - Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
 - Raporton perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
 - Kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.
 - Administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaku i vetem.



- Kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise.
- Te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.
- Ti propozoje ortakut te vetem per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise.
- Ti propozoje ortakut te vetem per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

Neni 11. Marreveshjet e ndaluara

11.1. Administratoret ose ortakët që nuk janë persona juridike nuk u lejohej të kontraktonte në çfarëdo lloji forme qofte, të marrin hua të shoqëria, të japin pelqimin në emer të saj, për paradhënie si dhe të behen dorezanes apo të garantojnë në emer të saj angazhimet ndaj të tremeve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore të ortakëve që janë persona juridike.

11.2. Kjo masë zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetes.

Kreu VI

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

12.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

12.2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i vetëm.

12.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13. Kontrolli i Shoqerise

13.1. Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortaku i vetem.

13.2. Eksperti Kontabel i Autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me integritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive si dhe fondet e shoqerise, kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit dhe ne raportin e administrimit, kontrollon te gjitha librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizojte eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

13.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakut te vetem.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 14

14.1. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si dhe ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaku.

14.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, ortaku i vetem emeron nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

14.3. Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakun e vetem te shoqerise.

Neni 15. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

15.1. Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Kreu VIII
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

16.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent.

16.2. Ky staut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

HUSEYIN SELCUK OCMEN

HUSEYIN SELCUK OCMEN

